

PËR NJË SHQIPËRI TË GJELBËR



PARTIA E GJELBËR

**Miratuar në Kuvendin e tretë të Partisë së Gjelbër
13 Dhjetor 2011**

PROGRAMI I PARTISË SË GJELBËR

Hyrje

Partia e Gjelbër është një parti e cila udhëhiqet nga mendime, ide dhe vlera bazuar në filozofinë e gjelbër. Ajo ka një vision të qartë për të ardhmen.

Duke menduar globalisht e vepruar lokalisht duam që gjurmët që lëm pas të jenë mirëqënia dhe ekozhvillimi.

Vizioni i Partisë së Gjelbër është për një shoqëri të qëndrueshme ekologjike dhe sociale ku ndërgjegjshmëria, solidariteti dhe liria bashkohen.

Partia e Gjelbër është një lëvizje që princip të politikës së saj ka një zhvillim të qëndrueshëm në Shqipëri dhe një mënyrë zhvillimi që respekton të drejtat e Njeriut, si lirinë, drejtësinë, barazinë, demokracinë, paqen dhe ngre bazat e përgjegjësisë për mjedisin.

Partia e Gjelbër është partia që kërkon rrugë të reja zhvillimi.

Në këtë program të partisë sonë, ne kemi pasqyruar përshkrimin e realitetit, vizionet dhe rrugët për të ardhmen që kërkojnë vullnet për ndryshime, përmirësime dhe progres.

Të gjitha idetë e reja ndeshen me mendimin që kjo është e pamundur dhe e parealizueshme dhe ka shumë njerëz që e pohojnë këtë.

Ne themi: Asgjë nuk është e pamundur. Ne mundemi nëse duam.

NE DUAM NËSE DHE JU DONI , MIRË SE VINI TE NE!

BASHKËRISHT MUND TË REALIZOJMË ATË QË TË TJERËT THONË SE ËSHTË E PAMUNDUR.

Pjesa I

PARIMET DREJTUESE

1.1 Përgjegjesi për mjedisin

Mbrojtja e mjedisit dhe burimeve natyrore është pjesë e përgjegjësive politike dhe ekologjike të Partisë së Gjellbër.

Ne mbështetim fort nevojën për të jetuar me mjetet tona ekologjike. Ne duhet të ruqajmë mjedisin, diversitetin biologjik, të kujdesemi për mosshaktërimin dhe përdorimin me kujdes të burimet natyrore të vendit.

Ne duhet të reagojmë duke vepruar konkretisht ndaj ndryshimeve klimaterike, ngrohjes globale, reduktimin e CO₂ dhe shkatërimin të mjedisit.

Por ndërmjet çdo nocioni të nevojshmërisë ne besojnë se secila prej specieve të gjalla të ndryshme në vendin tonë ka një vlerë të pazëvendësueshme dhe për këtë është e nevojshme të jetë e mbrojtur.

Dëshira për tu pasuruar sa me shpejtë, po kontribun në varfërinë e vazhdueshme të pjesës më të madhe të burimeve natyrore në vend duke shkaktuar një degradim të madh të mjedisit.

Ne kërkojmë që politikat ekonomike dhe tregtare të shërbejnë për objektivat sociale dhe mjedisore, jo vetëm si tregues ekonomik të rritjes së prodhit.

Përgjigja jonë është eko-zhvillimi, i cili integron objektivat mjedisore, sociale dhe ekonomike për të mirën e përgjithshme.

Eko-zhvillimi mund të arrihet vetëm nëpërmjet bashkëpunimit në të gjithë sektorët e jetës.

Zhvillimi i gjithanshëm ekonomik i vendit kërkon që vendimet dhe veprimet duhet të ndërmerren duke ndjekur sistematikisht një politikë paqësore mjedisore në dobi të ruajtjes së burimeve natyrore.

Secili ka të drejtë të jetojë në një mjedis të pastër dhe të shëndetshëm.

Gjithkush ka përgjegjësinë të mbrojë dhe të rregullojë mjedisin për të mirën e të tashmes dhe të ardhmes për brezat që do vijnë. Secili ka të drejtën e plotë të informohet mbi lejet e ndryshme të mjedisit përfshirë të drejtën e informimit për manipulimet gjenetike.

Çdo person ka të drejtë të kundërshtojë kur konstaton shkatërrime të mjedisit.

1.2 Mjedisi dhe Drejtësia Shoqërore

Edhe pse ekziston një preokupim i deklaruar për problemet mjedisore dhe shaktërimin e burimeve natyrore nuk vihet re asnjë shenjë ndryshimi. Nuk ka asnjë program politik serioz që të kërkojë ndërhyrjen për zgjidhjen e problemeve mjedisore dhe për të ndaluar shkatërrimin e burimeve jo të ripërtëritshme të vendit.

Për këtë arsye Partia e Gjelbër ka ndërtuar këtë program ambicioz dhe progresist bazë e të cilit është modifikimi në mënyrë të konsiderueshme i modelit ekonomik aktual të zhvillimit i cili pos jell pasoja të pariparueshme në mjedis dhe ndërtimi i një modeli të ri ekonomik miqësor me mjedisin.

Proçeset e natyrës janë të kërcënuara nga aktiviteti njerëzor. Për ta parandaluar këtë fenomen, Partia e Gjelbër mendonë se duhet ndalur varfërimi i burimeve natyrore të vendit duke stimuluar ekonominë që respektojnë mjedisin dhe investojnë kapitale për të evituar shkatërrimin e tij.

1.3 Autonomia Individuale

Të drejtat njerëzore janë të drejtat individuale bazë, të cilat nuk mund të reduktohen.

Janë të vlefshme për të gjithë banorët, pa diskriminim mbi bazë race, mundësie, orientimi seksual, besimi fetar, moshe, origjine kombëtare apo etnike.

Të gjithë këta duhet të kenë të drejtë të bëjnë zgjedhjen e tyre, të shprehin vetveten në mënyrë të lirë dhe t'i japin formën që duan jetës së tyre personale pa u ndikuar negativisht nga mendime të tjerëve.

Këto të drejta duhet të garantohen nga ligji dhe të mësohen në shkollë si baza fundamentale të shoqërisë tonë.

Partia e Gjelbër do të luftojmë për t'i pasur ato, duke propozuar solidarite, edukim, zhvillim, bashkëpunim dhe mbrojtje nga dhuna, presioni dhe diskriminimi.

1.4 Demokracia Përfshirëse

Partia e Gjelbër është për demokracinë parlamentare, sistemin pluripartizmit dhe autonomin e pushtetit vendor, për një sistem gjyqësor të pamvarur, për një rend

dhe qetësi të garantuar, për një shtet në shërbim të qytetarëve që të mbrojnë dhe sigurojnë të drejtat e njeriut sipas standarteve bashkohore dhe të Kushtetutës së Shqipërisë. Ne të gjelbërit, e konsiderojmë demokracinë si vlerën themelore të një shoqërie të përparuar. Ajo është garancia e popullit për të ndërtuar të ardhmen e tij, nëpërmjet delegimit të vullnetit të tij të lirë tek institucionet e dala nga vota e lirë.

Proçesi politik i vendimarrjes duhet të jetë demokratik, përfshirës, transparent dhe plotësisht i pranueshëm dhe të jepet në mënyrë të kuptueshme për njerëzit e thjeshtë.

Zhvillimi i qëndrueshëm ka nevojë për pjesëmarrjen dhe marrjen e përgjegjësive të të gjithë njerëzëve dhe gjithashtu kërkohet një ndarje e drejtë e të mirave materiale. Interesave të minoritarëve duhet t'u jepet vëmendja dhe kujdesi i duhur.

Partia e Gjelbër është për një shpërndarje të pushteteve në qeveri, me qëllim që të rritet influenca e popullit mbi vendimet që kontrollojnë jetën e tyre.

Ne duhet të kemi një shoqëri demokratike të decentralizuar me institucionet tona politike, ekonomike dhe shoqërore me pushtet në shkallë të vogël që është efiçente dhe praktik.

Ne jemi në veprim për të forcuar demokracinë në të gjithë vendin në nivele lokale, rajonale dhe kombëtare. Ne duam të forcojmë përgjegjësinë demokratike dhe efikasitetin e institucioneve vepruese.

1.5 Zgjerimi i Drejtësisë

Politikat e Gjelbëra janë bazuar në principet e drejtësisë. Kjo kërkon një shpërndarje të të mirave të shoqërisë dhe kjo si përfundim kërkon një vëmendje të veçantë për nevojat e më të dobhtëve. Vëmendja ndaj më të dobhtëve është në mënyrë të veçantë në nivelin kombëtar, ku vendi me politikat që ndjek ka një përgjegjësi specifike për të stimuluar rritjen ekonomike dhe zhvillimin e qëndrueshëm, eko-zhvillimin.

Partia e Gjelbër është për drejtësi sociale, për të drejtat e barabarta për gratë, për drejtësi midis brezave dhe për drejtësi në nivelin kombëtar dhe lokal.

- ***Drejtësia sociale*** siguron që çdonjëri të ketë akses në **resurset** vitale dhe sociale: shkollimin, punën dhe pjesëmarrjen demokratike. Një akses i drejtë duhet të mbrohet institucionalisht.

Shkollimi është një faktor vendimtar në mënyrë që t'i japi formë jetës së secilit person. Pjesëmarrja demokratike është një kërkesë bazë për të qënë të përfshirë në shoqëri dhe për të ndihmuar që t'i japim formë asaj.

- **Barazia gjinore.** Drejtësia është gjithashtu një e drejtë gjinore. Gruaja dhe burri duhet të gëzojnë të njëjtën fuqi dhe kështu t'i japin një përkufizim se si do të jetë zhvillimi i shoqërisë më pas. Gjithmonë ato duhet të jetojnë jetën e tyre në paqe.

Ne ,të Gjellbërit duam të zhvillojmë rrjetin e punës institucionale e cila garanton barazinë e gruas në shtëpi, në punë, në mjediset publike dhe në pozicione të tjera me influencë.

Ne duam të kemi harmoni në familje dhe në jetën profesionale për të dyja gjinitë.

- **Drejtësi midis brezave.** Sot, e ardhmja e fëmijëve tanë është në rrezik. Drejtësi ndërmjet brezave do të thotë një obligim për brezat më të vjetër për t'i dhënë në dorëzim trashëgiminë ambientale, sociale dhe kulturore më të rinjve në një mënyrë të qëndrueshme. Ajo gjithashtu përfshin një obligim për brezat më të rinj për t'u kujdesur për brezat më të vjetër të popullatës.

Ajo duhet të sigurojë që të gjithë brezat mund të marrin pjesë plotësisht në shoqëri.

1.6 Diversiteti

Shoqëria, civilizimi dhe kultura janë zhvilluar nëpërmjet ndryshueshmërisë. Diversiteti rrit bashkëveprimin ndërmjet organizatave dhe grupeve kudo që ato janë përballur me ndryshime të papritura. Ai është një masë paraprake kundër intolerancës, ekstremizmit dhe totalitarizmit.

Ai është një burim inspirimi për gjëra të reja.

Diversiteti human ka një sërë dimensionesh : gjinore, sociale, kulturele, shpirtërore, filozofike, fetare, gjuhësore, ekonomike, etnike, seksuale, rajonale. Kjo mund të shprehet prej individëve ose prej grupeve sociale.

Ne duhet madje të mbrojmë **diversitetin në opinione dhe sa në orientime politike po aq në ato ideologjike.**

Po ashtu ne përkrahim mbrojtjen e **diversitetit të specive në natyrë**

Diversiteti duhet mbrojtur në ato momente që rrezikohet dhe ka nevojë për njohje, kuptim të heshtur dhe respekt, dhe sa herë të jetë e nevojshme, mbrojtje aktive.

1.7 Jo – dhunës

Format kundër dhunës janë një pjesë kryesore e filozofisë së gjelbër.

Një princip bazë i Të Gjelbërve është që mjetet e përdorura për zgjidhjen e konflikteve duhet të kenë si objektiv drejtësinë dhe paqen. Veprimi njërëzor dhe strukturat administrative dhe ekonomike kombëtare apo lokale me veprimtarinë e tyre mund të privojnë njerëzit për të drejtat e tyre njerëzore duke bërë një padrejtësi sociale

Të Gjelbërit janë për ndalimin e këtyre formave dhe forcimin e mirëkuptimit.

Të Gjelbërit duan të shohin sa më pak ndërhyrje ushtarake dhe implementimin e konceptit të një politike për siguri civile. Kjo kërkon zhvillimin e çështjeve të rëndësishme për parandalimin si edhe menaxhimin e konflikteve civile.

1.8 Drejtësi Globale

Lufta për të drejtat e njeriut, për demokraci, drejtësi si dhe një politikë të mjedisit të qëndrueshëm nuk na përket vetëm ne në Shqipëri.

Dëshira jonë është të krijojmë një botë më të mirë që nuk njeh kufijtë nacional.

Globalizimi është fjala kyçe e kohës së re.

Teknologjia e informacionit si dhe zhvillimi teknik na ka afruar më afër njëri tjetrit, njëkohësisht padrejtësitë, varfëria si dhe problemet e mjedisit në botë janë shtuar.

Bota është sot përball sfidave gjigante. Uria në botë dhe sëmundjet janë një dukuri e dukshme e një pjese të madhe të njerëzimit. Konfliktet e armatosura, shtypja, si dhe kufizimet e të drejtave qytetare, njerëzore dhe politike, pengojnë mundësitë e njerëzve që ata të jetojnë në liri.

Për ne është e papranueshme që njeriu të vdes nga mungesa e ushqimit.

Ne dëshirojmë që Shqipëria të veprojë së bashku me lëvizjet e solidarizimit dhe të japë kontributin e saj në zhdukjen e varfërisë globale. Ne angazhohemi dhe përkrahim një solidarizim global dhe një rend të drejtë në botë.

Pjesa e II

EKO-ZHVILLIMI

2.1 Ekonomi për një zhvillim të qëndrueshëm.

Të shfrytëzosh atë që është e shfrytëzueshme , krijon vetëm në aparence një mirëqenie individuale dhe kolektive.

Ne dëshirojmë të kemi një zhvillim ekonomik afatgjatë e të qëndrueshëm, që nuk ndërtohet mbi shfrytëzimin e pamëshirshëm të burimeve natyrore si dhe mbi shkatërrimin e mjedisit. Synimi kryesor ekonomik duhet të jetë që t'i plotësojë nevojat e njerëzve, njëkohësisht të krijojë kushtet të mira jetese për brezat e ardhshëm. Një politikë e tillë është një politik e progresit real, pasi sjell më shumë vende të lira pune, si dhe më pak shkatërrim të mjedisit.

Përparimin ekonomik të vendit, Të Gjellbërit e shohin nëpërmjet zhvillimit të qëndrueshëm në harmoni me mjedisin.

Solidarizimi është piknisja e një ekonomie të gjellbër.

Qëndrueshmëria nuk do të jetë e mundur për sa kohë do të ekzistojë varfëria dhe populli të jetojë një pasiguri materiale. Partia e Gjellbër ndjek një politikë ekonomike e cila nisat nga nevojat për të ardhmen.

Ne nuk i pranojmë dallimet në rritje të të ardhurave. Një ndarje e drejtë dhe një mirëqenie funksionale, duhet t'u garantojë të gjithë njerëzve siguri themelore.

Ne besojmë në zhvillimin ekonomik dhe teknik. Një ekonomi e së ardhmes ndërtohet mbi teknologjitë të kursimit të burimeve natyrore.

Nëse zhvillimi do të shkojë në drejtim të duhur, larg nga varësia e naftës, shpenzimit të tepruar të burimeve si dhe shkatërrimit të mjedisit, atëherë janë mundësitë për zhvillim të ekonomisë duke zhvilluar dhe futur në përdorim teknologjite e reja, të cilat kursejnë burimet dhe mjedisin.

Ne dëshirojmë të ulim taksat e punës që të krijohen më shumë vende të lira pune dhe të punësohen më shumë njerëz, njëkohësisht duhet të rriten taksat e energjisë, të lëndëve të para si dhe për derdhjet e rrezikshme për mjedisin, çka jep arsye ekonomike për ta hequr përmes racionalizimit, shkatërrimin e mjedisit .

Një pjesë e të ardhurave nga ekotaksat duhet të përdoren për promovimin e produkteve ekologjike.

Çmimet duhet të tregojnë të vërtetën ekologjike, ato duhet të shprehin koston shoqërore dhe ambientale.

Shtylla e ekonomisë së gjelbër është forca krijuese e njerëzve si dhe angazhimi i tyre. Ne dëshirojmë të fuqizojmë prodhimet dhe tregjet lokale, si rrjedhojë do të kemi transporte me të shkurtra. Zhvillimi i ekonomisë lokale dhe rajonale do të sjelli zhvillimin e gjithanshëm të vendit. Sot koha është gjëja më e kufizuar.

Sistemi i sotëm, ku njerëzit sëmuren nga njëra anë për shkak të ngarkesës së rëndë nga puna, dhe nga ana tjetër ndjehen keq nga papunësia, është një harxhim i tepruar i burimeve. Prandaj ne punojmë për ta shkurtuar orarin e punës.

Ne dëshirojmë t'i forcojmë të drejtat e konsumatorëve dhe para së gjithash, ta forcojmë të drejtën e informimit se çka përmban një artikull, si është prodhuar dhe ku është prodhuar ai artikull.

Ne dëshirojmë që politika ekonomike duhet të ndërtohet mbi principin e drejtësisë dhe solidaritetit, ato të jenë të qëndrueshme nga aspekti social dhe ai i mjedisit.

2.2 Industria e Gjelbër

Zhvillimi i industrisë së gjelbër merrë një rëndësi të vecantë në kushtet e një krize të ekonomisë globale. Në vendin tonë është bërë pak në këtë drejtim . Të gjelbërit janë për zhvillimin e këtij sektori si një nga prioritetet e politikave qeverisëse. Zhvillimi i kësaj industrie do të sjell dhe zhvillimin e sektoreve të tjerë të vendit. Zhvillimi i industrisë së riciklimit, i përpunimeve të produkteve ekologjike si dhe tektologjive të gjelbëra do të sillnin jo vetëm një zhvillim dhe rritje ekonomike të qëndrueshme, por dhe uljen në mënyre të dukshme të papunësisë . Zhvillimi strategjik i një ekonomie dhe industrie të gjelbër do të ishin një garanci për të ardhmen pasi do të sillnin një zhvillim të qëndrueshëm në të gjitha sektoret.

2.3 Transportet

Problemi ambiental i transportit duhet të zbutet nëpërmjet investimit në transportin e pastër publik, planifikimin sensibil të linjave dhe tatimin e të gjithë karburanteve në të gjithë sektorët.

Qytetet pa makina, tatimi i karburanteve dhe zbatimin e taksave për mjetet e transportit që ndotin ambientin, duhet të jenë rregulla.

Partia e Gjellbër është për një politikë transportesh që sheh qartë nga e ardhmja. Përparësitë e kësaj politike janë: Në projektet e së ardhmes duhen të shikohen si investime të preferueshme ato të hekurudhave.

Ka ardhur koha e përdorimit të rrjeteve të metrosë dhe tramvajit modern, solar bus dhe trolebus, si dhe makinave që ndotin më pak ambientin për lëvizjen e njerëzve në qytete.

Një qytet që bën jetë të mirë, ku gjen kënaqësi dhe ku fëmijët luajnë në rrugë, është ai qytet ku vetura është e rrallë.

Nuk është veçse një zgjedhje e popullësisë, prandaj dhe të gjithë përfitojnë nga përmirësimi i cilësisë së jetës. Një aspekt tjetër i këtij projekti është afrimi i vendit të punës me banesën dhe ndërtimi i infrastrukturës funksionale brenda një komuniteti e cila do të reduktonte nevojat për zhvendosje.

Biçikleta duhet konsideruar si një mjet shumë efikas i transportit publik. Për këtë duhet krijuar infrastruktura e vejoshme duke i paisur rrugë e qyteteve me një korsi të veçantë dhe të sigurtë për të.

2.4 Energjia

Nëse flitet për naftë apo gaz, kërcënimi nuk është vetëm shterimi për sa i përket shtresave, por është gjithashtu rreziku i ndryshimeve klimatike globale si shkak i shtimit të efektit serë. Nëse do të pritet për rrezikun, të jemi të sigurt që do të jetë shumë vonë për të shmangur ngrohjen globale.

Modeli i zhvillimit i krijuar mbi përdorimin gjithmonë në rritje të rezervave energjetike, është një ekonomi e uljes së një kapitali natyror, të brezave të ardhshëm. Ai është i destinuar të mbarojë.

Në mënyrë specifike për sa i përket energjisë nukleare, Partia e Gjellbër është që në Shqipëri as duhet të mendohet të prodhohet energji nukleare, për rezikshmërin që mbart për të sotmen dhe të ardhmen.

Për ne Të Gjellbrit, e ardhja i përket energjive të rinovueshme.

Pas disa dekadave, energjitë fosile dhe nukleariteti do të jenë zëvendësuar me energji të rinovueshme, të lejueshme për të gjithë. Burimet e energjive të rinovueshme mbeten të pashfrytëzuara në Shqipëri.

Të Gjëlberit janë për një politike moderne, duke zhvilluar me prioritet energjitë e rinovueshme, si dhe në të njëjtën kohë ushtrimin e kontrollit për ekonomizimin e energjisë.

Të Gjëlberit janë për:

- Ngrohjen me dru, duke përdorur me çmimin më të vogël një resurs lokal të rinovueshëm
- Për ndërtimin e banesave që mundësojnë projekte të ekspozuara ndaj dritës dhe një pjesë e mirë e ngrohjes se tyre dhe e ujit duhet të sigurohen direkt nga dielli (arkitekturë bioklimatike).
- Për elektricitet me origjinë nga era i cili është shumë konkurrues nga ana ekonomike dhe shumë vende kanë nxjerrë programe të mëdha pajimesh (Elektriciteti me origjinë diellore (fotovoltaike) është gjithashtu me kostot tashmë konkurruese.
- Për cdo burim tjetër energjie të rinovueshme miqësor me mjedisin.

2.5 Bujqësia

Përkrahja e bujqësisë sot është një çështje shumë e rëndësishme. Ky është një nga sektorët më të rëndësishëm të ekonomisë së vendit. Ne duhet të punojmë për riorganizimin e këtij sektori sipas një strategjie afatëgjatë bazuar në modelet përrëndimore. Ne do të synojmë të drejtë një bujqësie të qëndrueshme.

Ne do të nxisim dhe inkurajojmë që sektori i bujqësisë të përdorë sa më pak **impute** bujqësore , si pesticidet dhe plehrat kimike apo të përdorimit të hormoneve dhe inxhinierisë gjenetike.

Çmimi i produkteve duhet të reflektojë koston ambientale dhe shoqërore të prodhimit ushqimor, sepse fermerët duhet të kujden për natyrën.

Ne do të mbështesim fermerëve që dëshirojnë të kalojnë në bujqësi ekologjike ,si në aspektin e prodhimit ashtu dhe tregimit të prodhimeve ekologjike.

Ne duam të vazhdojmë punën për të rritur përkrahjen dhe mështëtjen e bujqësisë ekologjike.

Zhvillimi i bujqësisë biologjike duhet të jetë një nga prioritet, pasi jo vetëm janë kushtët e përshtatshëm për zhvillimin e saj, por ajo do të stimulojë dhe rrisë dhe sektorin e turizmit ekologjik në vend.

- ***Bioteknika***

Teknika e re gjenetike jep mundësi të mëdha por ka edhe rreziqe.

Ne e shohim rrezikun në ato studimet shkencore ku zbatimi dhe marketingu drejtohen nga interesat e përfitimit. Ne duam të ashpërsojmë ligjin rreth të cilave eksperimente për sa i përket manipulimit gjenetik duhet lejuar. Ne duam që të drejtat e kafshëve për një jetë të natyrshme të bëhet realitet. Të ndalohet manipulimi gjenetik dhe përdorimi i hormoneve për rritje në prodhimin e ushqimit.

- ***Ushqimi bio dhe shendet***

Bujqësia biologjike është një mënyrë prodhimi moderne, duke ditur të lidhësh kërkime shumë të avancuara me traditat e mira për t'u ruajtur. Bujqësia biologjike ka ditë të bukura para saj, në kushtet e një kontrolli të rreptë dhe të një respekti strikt të detyrimeve shoqëruar nga nje informim korrekt i konsumatoreve, sidomos kur bëhet fjalë për ushqim, të cilit i janë manipuluar gjenet, janë trajtuar me antibiotikë dhe rrezatim.

Të gjithë duhen garantuar për artikuj ushqimorë të cilësisë së lartë, të pastëra nga substanca helmuese. Të gjithë artikujt ushqimorë të pajisen me deklaram të qarta rreth përmbajtjes së tyre në gjuhën shqipe, ku çdo pjesë përbërëse të deklarohet.

Ne jemi kundërshtarë të rrezatimit të ushqimit dhe preferojmë kujdesshmëri në përdorimin e teknikës së manipulimit gjenetik. OMGJ-të duhet të mbahen larg tregjeve tona.

Ne dëshirojmë të kemi ushqim të cilësisë se lartë dhe biologjik.

2.6. Turizmi dhe Eko-Turizmi

Zhvillimi i Turizmit në përgjithësi dhe veçanërisht i Eko-Turizmit shikohet si një prioritet i Partisë Gjellbër për vetë kushtet e favorshme që ka vendi ynë. Për zhvillimin e këtij sektori duhet një strategji afategjatë dhe e qëndrueshme. Zhvillimi i këtij sektori do të sillte të ardhura të konsiderueshme në ekonominë e vendit por dhe zhvillimin e një sërë sektoresh të tjerë si, bujqesia biologjike, industria e gjelbër, transporti ekologjik, energjite e gjelbëra, etj. Nga ana tjetër do të krijonte dhe një sërë vende pune të reja.

Pjesa III

POLITIKAT SOCIALE

3.1 Drejtësia Sociale.

Çdo person ka të drejtën e edukimit të lirë, mbojtje sociale dhe një minimum jetik të garantuar. Të Gjëlberit insistojnë në prezantimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të sigurisë sociale, i cili mbulon nevojat bazë të të gjithë njerëzve dhe që nuk varet nga puna e paguar. Të Gjëlberit janë për një shoqëri humane dhe mbrojtje sociale, që synon zhdukjen e varfërisë, shtimin e vëndeve të punës, përmirësimin e shërbimeve të strehimit dhe ngritjen cilësore të jetës së popullit. Të Gjëlberit mbështetin rritjen e rolit të sigurimeve shoqërore dhe të shërbimit shëndetësor duke përkrahur një politike shëndetësore masive. Sigurimin e një niveli minimum të ardhurash për çdo shtetas nëpërmjet skemës së asistencës sociale.

- ***Lidhur me nevojat bazë të shoqërisë:***

Çdo njeri gëzon të drejtën e punës së paguar. Çdo njeri ka të drejtë të refuzojë punën individuale e cila është e dëmshme për shëndetin dhe ambientin. E drejta e pjesëmarrjes, informacionit dhe konsultimit të punonjësve duhet të përhapet për të lejuar një sensibilitet më të madh lidhur me ambientin.

3.2 Punësimi

Papunësia po merr përmasa galopante në raport me numërin e popullësisë aktive. Hapja e vendeve të reja të punës është e domosdoshme për të shmangur varfërinë. Duhet rivënë ekonomia në shërbim të njerëzimit. Ne duhet ta orientojmë zhvillimin e vendit drejtë një ekonomie të qëndrueshme në të gjitha fushat. Për këtë kërkohet një strategji e re dhe afatgjatë zhvillimi e cila do të mundësonte dhe krijimin e vendeve të reja të punës si në sektorin publik dhe privat. Zhvillimi i sektorëve të ndyshëm si : bujqësisë, turizmit, energjisë së rinovueshme, teknologjive të Gjëlbera etj, do të garantonte vendte të reja pune të qëndrueshme. Një formë tjetër për të krijuar më shumë vende pune është dhe aplikimi i stimulimet. Kjo mund të arrihet duke inkurajuar shkurtimin e kohës së punës. Punësimi gjithashtu duhet stimuluar nga ulja e taksave të punës. Duhet absolutisht të krijohet një sistem që do të lejojë mbështetjen dhe konsolidimin afatgjatë të sektorit të

punës. Të Gjëlberit janë për krijimin e të gjitha kushteve për të punësuar dhe integruar invalidët dhe të pamundurit në shoqërinë tonë.

- ***Të punojmë më pak për të punuar të gjithë***

Ose të pranojmë që shoqëria të mbetet e ndarë në dysh midis atyre që nuk punojnë dhe atyre që "shpenzojnë jetën për të fituar", ose të vendosim të reduktojmë kohën e punës dhe të shpërndajmë të ardhurat.

Reduktimi i kohës së punës duhet vënë në funksionim.

Një shpërndarje e punës duhet të ndikojë në shpërndarjen e përfitimeve nga puna dhe reduktimin e pakënaqësive. E gjitha do të jetë funksion i ndryshimit të mënyrës së të menduarit. Ne nuk ndajmë iluzionin sipas të cilit po të prodhosh më shumë, kjo do të lejonte një ndarje më të mirë të të ardhurave. Logjika e ekonomisë aktuale, që e bën rritjen e saj një qëllim në vetëvete, duhet ndryshuar. Duhet rivënë ekonomia në shërbim të njerëzimit, duke rishpërndarë të ardhurat dhe punën, duke stimuluar aktivitetet e kohës së lirë.

3.3 Green Job

Partia e Gjëlber mbështet forte politikat e punësimit të gjëlber. Pasi punësimi i gjëlber jo vetëm do të reduktonte papunësinë, por do të krijojne vende pune të qëndrueshme. Zhvillimi i sektorit të Gjëlber do të krijojne mijëra vende të reja pune. Vetë zhvillimi i energjisë së rinovueshme, bujqësisë biologjike, eko-turizmit, industries së riciklimit, industrive dhe teknologjive të tjera të gjëlbera, etj do të ishin një garanci për krijimin e green jobs.

3.4 Strehimi

Një çati është një e drejtë.

Çdo vit shtrohet problemi i shtëpive. Shoqëria mund dhe duhet të japë mjetet për të ndërtuar ndërtesa të destinuara për të strehuar në mënyrë të qëndrueshme popullësinë. Kërkesa për banesa të lira është një përgjigje urgjente dhe e nevojshme. Duhet zbatuar një politikë ambicioze për banimin social. Të Gjëlberit janë për ngritjen e basesave sociale, ku shteti të marrë përsipër ngritjen e tyre ose kreditimin afatgjatë me interesa të ulta.

3.5 Shëndeti.

Kujdesi shëndetësor dhe ai mjekësor është një pjesë kryesore e mirëqënies.

Kujdesi ynë i financuar bashkërisht, nuk duhet të jetë një ide biznesi, por duhet të funksionojë mirë dhe të jetë një institucion i drejtë pa interes fitimi. Kjo do të thotë që i gjithë kujdesi mjekësor, duhet të jetë publik.

Ne kemi qëndrim pozitiv për inisiativa private , si alternativa të ndryshme menaxhimi. Në këtë mënyrë rriten mundësitë e pacientit për të zgjedhur. Zhvillimi ekonomik dhe shëndetësor sot ka bërë që njerëzit të jetojnë më gjatë, por, njëkohësisht sëmundjet e mirëqënies janë shtuar dhe faktorët e mjedisit luajnë një rol më të rëndësishëm. Kujdesi shëndetësor dhe ai mjekësor në të ardhmen duhet të ketë një përfshirje më të gjërë dhe një angazhim për t'i parandaluar sëmundjet.

Ne duhet të kujdesemi për një mjedis të përmirësuar të punës, zvogëlimin e konsumimit të duhanit, alkoolit dhe drogës, si dhe për një jetë me më pak stres, por edhe ndryshim të shprehive të ushqyerit dhe të ushtruarit të lëvizjes fizike.

Ne dëshirojmë që kujdesi mjekësor të jetë afër njerëzve. Kujdesi shëndetësor në afërsi, si mjekimi i planifikuar , ashtu edhe ai urgjent, duhet të ndërtohet mbi bazat e sigurisë dhe dispozicionit.

Është me rëndësi që të ketë për të gjithë në shoqëri një kujdes të mirë dentar, jo vetëm për ata që kanë mundësi financiare të paguajnë vetë. Arsimimi dhe trajtimi duhet të jenë padyshim i kualitetit të lartë, prandaj ka nevojë për një qëndër shkencore shtesë alternativë mjekësie, me drejtime shkencore të tërthorta.

- *Sot lind dhe vdes ne spital.*

Por jeta nuk është sëmundje. Të Gjelbërit janë për marrjen e një sërë masash paraprake për parandalimin e faktorëve që na detyrojnë të sëmuremi , që kanë lidhje me ndotjen e ambientit , ajrit, ujit dhe tokës.

- *Është më mirë të parandalosh se sa të shërosh, pasi kjo ka edhe kostot e saj sociale.*

Tema e shëndetit insiston në kuptimin popullor shpesh të përsëritur :

“Të paktën mirë me shëndet pa të tjerat do rregullohen”. Por shëndeti ka një çmim. Prandaj për këtë ne “Të Gjelbërit” krahas ngritjes se një sistemi të mbrojtjes sociale në shërbim të njerëzve jemi për ndërgjëgjësimin e tyre, për luftimin e shkaqeve dhe fenomeneve që sjellin pasoja për shëndetin.

3.6 Ambienti dhe shëndeti

Janë në fakt dy faqet e së njëjtës medalje.

Prodhimi industrial, sjelljet e qytetarëve, përdorimi i automjeteve, shkarkimi i ujërave, përdorimi i prodhimeve të caktuara dhe shumë situata të tjera përcaktojnë efekte të rënda herë-herë të pakthyeshme mbi ambientin dhe më pas mbi shëndetin. Për këtë arsye është e nevojshme të kujdesemi për mjedisin duke shmangur nivelet e larta të ndotëjes si dhe shkatërimin e burimeve natyrore.

Duhet rregulluar me ligj aktiviteti industrial, ai bujqësor, të drejtat dhe detyrimet e çdo subjekti të interesuar nga firmat private deri në administratën publike, nga shoqatat deri tek qytetari i vetëm. E gjitha kjo jo për të ndëshkuar atë që punon dhe prodhon, por për të garantuar qartësinë e të drejtave në lidhje me çështjet e ambientit.

Për ne , Të Gjelbërit është e pa pranueshme që ambienti të jetë shkaktari një sërë sëmundjesh.

- ***Drogat legale dhe ilegale***

Abuzimi me drogat legale (alkol, duhan) është shkaku i parë i sëmundjeve. Ne kërkojmë ndërprerjen e të gjitha formave të publicitetit për këto droga dhe parandalimin e tyre me anë të informacionit veçanërisht në ndërtesat shkollore.

Për sa i përket drogave të palejueshme, shumëfishimi i ndjekjeve dhe rëndimi i dhimbjeve nuk kanë ndryshuar asgjë. Ne mendojmë se shtetit duhet ta marrë përsipër dhe ta përballojë këtë problem të shëndetit publik qoftë dhe duke përmirësuar legjislacionin.

Qoftë për drogat legale, qoftë për ilegale, parandalimi është më i preferuar. Pra duhen luftuar shkaqet që janë papunësia, vetmia apo jetesa e keqe, produkte të shoqërisë sonë në të cilën konkurrenca dhe përfitimi janë **glorifikuar** në dëm të vlerave të solidaritetit dhe vëllazërimit.

3.7 Cilësia e Jetës

Synimi për të pasur një zhvillimin ekonomik të lartë nuk mund të justifikojë shtimin e streseve të shumta, nuk duhet të na lejojë që të sëmuremi më shumë e të kemi më pak kohë për shokët, familjet dhe ëndërrat tona.

Megjithatë na duket se shoqëria nuk është duke u bërë më njerëzore me kohën, por është duke u ashpërsuar. Gjatë viteve të fundit stresi është rritur dhe jo vetëm në botën e të rriturve , por edhe tek fëmijët.

- ***Ne duam ta bëjmë jetën e njerëzve me cilësore.***

Puna për të siguruar një pagë nuk duhet të jetë gjëja kryesore në jetën e njeriut dhe se strukturat e shoqërisë, sistemet dhe normat nuk duhet të zhvillohen në mënyrë të njëanshme për ta përshtatur njeriun si punëtor me pagë. Ne duam që njerëzit në të të ndërtojnë respektin dhe ndjenjën për vetëveten.

Ne synojmë që sistemi ynë i sigurisë mos të varet vetëm nga lidhja e punës me pagën.

- ***Orar më i shkurtuar i punës***

Zvogëlimi i orarit normal të punës është i rëndësishëm për cilësinë e jetës dhe rritjen e lumturisë. Vizioni ynë është një orar i punës prej 30 orësh në javë. Kjo do të hapte vende të reja pune dhe njëkohësisht do të zvogëlohej stresi dhe njerëzve do t'u jepej më tepër mundësi të zhvillohen si individ dhe të shoqërohen me shoqërinë dhe familjet e veta.

Zvogëlimi i orarit javor të punës është një çështje kyçe për barazinë midis meshkujve dhe femrave. Me orar të shkurtuar më shumë femra do të mund të punonin me orar të plotë, ndërsa meshkujt do të kishin më tepër kohë për punë shtëpie dhe edukimin e fëmijëve

- ***Vit i lirë***

Mundësia për një vit të lirë është një reformë tjetër për një papunësi më të ulët dhe rritje të cilësisë së jetës. Kjo do të thotë se një punëtor mund ta marrë të lirë një vit me pagesë nga arka e sigurimit të papunëve, me kusht se një i papunë e merr vendin tij të punës për këtë kohë.

Ne duam që mundësia për një vit të lirë të bëhet realitet sin ë aspektin lokal dhe kombëtar si një e drejtë ligjore.

3.8 Siguria Themelore

Botëkuptimi ynë themelor është se të gjithë njerëzit kanë vlerë të njëjtë dhe se të gjithë njerëzve t'u garantohet mundësia për një jete dinjitoze.

Ne mendojmë se të gjithë njerëzve duhet t'u garantohet një siguri themelore. E drejta për siguri themelore duhet t'i përfshijë të gjithë, pavarësisht nëse i përshtaten apo jo modeleve të sotme për ndihma të ndryshme ekonomike. Ne propozojmë një ndryshim radikal të sistemit të ndihmës ekonomike dhe të sigurimeve shoqërore. Siguria themelore do t'i zëvendësojë të gjithaformat e ndihmave ekonomike për ekzistencë dhe do t'i përfshinte të gjithë qytetarët.

Një hap i parë në drejtim të sistemit të sigurisë themelore do të ishte rritja e niveleve bazë e sistemit të sigurimeve sociale.

3.9 Edukimi

Ne mendojmë se shkolla duhet të jetë një vend për të gjithë, ku fëmijët dhe rinia me kushte të ndryshme nga ambiente dhe kultura të ndryshme mësohen të jetojnë bashkë duke e respektuar njëri tjetrin. Por shkolla duhet të jetë edhe një vend, ku nxënësve me nevoja të posaçme u jepet ndihmë dhe përkrahje. Për këtë kërkohen investime, më shumë arsimtarë të kualifikuar dhe pedagog specialë dhe një proces më i individualizuar mësimor. Ne jemi për shkolla të vogla dhe vetëqeverisëse dhe për ruajtjen e shkollave të komunave. Shkollat e mëdha duhen ndarë në njësi vetëqeverisëse. Çdo shkollë duhet të ketë një drejtor të përbërë nga kuadri i shkollës, nxënësit dhe prindërit.

Ne dëshirojmë të shohim një zhvillim më madh në drejtim të shkollave me ide të ndryshme pedagogjike, me drejtime e profile të ndryshme edhe në kuadër të shkollave komunale. Të Gjellbërit janë për një politikë arsimore përparimtare dhe të hapur ku të gjithë nxënësit që mbarojnë shkollën e mesme të kenë të drejtë të vazhdojnë shollën e lartë. Të gjithë të kenë të drejtë të mbarojnë shkollën e mesme të përgjithshme pamvarësisht nga mosha që kanë. Të gjithë studentët apo nxënësit që kanë lënë përgjysmë studimet të kenë të drejtë t'i vazhdojnë ato në një kohë tjetër pamvarësisht nga mosha e tyre. Ne jemi për një sistem me pagesë që i lejon secilit për të patur një ose më shumë diploma, duke u rikthyer në shkollë gjatë gjithë jetës nëse ai e dëshiron këtë.

Ne duam demokratizimin e jetës liceiste dhe studentore nëpërmjet njohjes së shoqatave dhe sindikatave të tyre. Ne duam një politikë ambicioze e cila do të merrte masat e nevojshme për të lejuar futjen e fëmijëve me aftësi të kufizuar në shkollë.

3.10 Fëmijët

Të ardhmen ne e shikojmë në sytë e tyre. Çdo vendim politik apo ekonomik që ndërmerret duhet të na bëjë që të kthejmë kokën nga ata, sepse ata kërkojnë një shoqëri të sigurtë për të nesërmen. Të gjithë fëmijët kanë të drejtë për një jetë me dashuri, respekt dhe pa u diskriminuar. Çdo fëmijë duhet parë dhe duhet të ketë mundësi të zhvillohet, duke u nisur nga parakushtet që ai ka. Çdo fëmijë ka të drejtë të gëzojë një mjedis të pastër dhe të shëndetshëm.

3.11 Rinia

Sot, ankthi i të rinjve për të ardhmen dhe mosbesimi i tyre është shumë i madh. Pjesa më e madhe e rinisë e dinin se starti i tyre pas moshës 18 -vjeçare do të jetë më i vështirë se i prindërve të tyre.

Të gjelbërit synojnë të kontribuojë në krijimin e një ambienti ku të rinjtë shihen si burim kryesor për zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të vendit. Fuqizimi i kësaj pjese të popullatës është vendimtar, kur merret parasysh përbindja e tyre në pasqyrën demografike të vendit. Duhet bërë më shumë në drejtim të zhvillimit të infrastrukturës për edukim, përkrahjen e aktivitetit biznes të të rinjëve, aftësimin profesional, krijimin e kushteve për një lëvizshmëri më të mirë në vendet evropiane si dhe stimulimin e aktiviteteve kulturore, sportive dhe argëtuese.

- ***Papunësia e të rinjve***

Të deklarosh ilegale papunësinë e të rinjve është një sllogan mbase efikas, por kjo nuk e zgjidh çështjen. Që një vend të mos ketë asgjë për t'i propozuar rinisë është **thjeshtë** skandaloze. Ne sot duhet të luftojmë kundër papunësisë së të rinjve dhe stimulimin e hapjen e vendeve të reja të punës për të rinjtë. Të Gjelbërit janë për ndarjen e punës si një çështje solidariteti midis gjeneratave, si ndarja e kohës së lirë apo e kohës së formimit. Të rinjve që mbarojnë shkollën e lartë , shteti duhet t'iu japë një vit asistencë derisa të gjejnë punë. Ky do të jetë viti i praktikimit të tyre.

3.12 Gratë

Gratë përbëjnë thujse gjysmën e genit njerëzor. Barazia juridike dhe legjislative, ju desh shumë kohë e gjate për t'u arritur, Erdhi në sajë të një lufte shekullore të grave. Ajo thujse është realizuar tashmë. Në botën e punës, gratë janë akoma minoritare në këtë kuadër dhe në gjithë funksionet më të vlerësueshme. Ato janë akoma më pak të paguara se burrat me të njëjtin nivel kualifikimi. Për këtë arsye duhet akoma për t'u arritur disa fitore legjislativeë dhe gjithashtu mund të evoluojnë mentalitetet duke vepruar p.sh. mbi edukimin. Jashtë sferës private dhe ekonomike, pabarazia me flagrante është në fushën e politikës. Përfaqësimi i grave nuk është një çështje kuotash, por është thjesht rivendosje e një përfaqësimi të drejtë, pra të barabartë. Në demokraci, ndryshimi i sekseve nuk mund të jetë burim mosbarazie.

- ***Feminizmi***

Feminizmi ka të bëjë me demokracinë dhe lirinë. Si gratë, po ashtu edhe burrat, kufizohen nga një normë gjinore, e cila përcakton se si duhet të jemi. Ne dëshirojmë ta ndryshojmë rregullin e pushtetit gjinor, i cili pengon barazinë ekonomike, sociale dhe politike. Përvoja e grave, besueshmëria dhe aftësia e tyre, është bërë shprehi, të vihet në dyshim. Gratë kanë paga më të ulëta për të njëjtën punë dhe këto përveç kësaj, goditen nga përqendrimi në to si objekt seksual. Pabarazia manifestohet në formën më të vrazhdë, përmes dhunës së burrave, të cilët ushtrojnë ndaj grave të drejtat të njëjta dhe barazia janë çështjet themelore të demokracisë., prandaj, politika duhet të ndryshohet në të gjitha fushat, ashtu që gratë dhe burrat t'i kenë kushtete barabarta. Të Gjellbërit ftojnë gruan të jetë e mundur të marrë pjesë plotësisht në të gjitha sferat ekonomiko shoqërore si dhe për një pjesëmarrje dhe përgjegjësi individuale të burrave në të gjithë aktivitetet shoqërore joekonomike. Diskriminimi në bazë seksi në të gjitha sferat e jetës kulturore dhe shoqërore duhet të jetë i ndaluar. Duhet të kemi aksione pozitive për pjesëmarrjen e gruas në fusha publike dhe private derisa të dy sekset të arrijnë barazinë. Masat që sigurojnë pjesëmarrjen e barabartë në të gjitha fushat lidhur me kujdesin duhet të gjenerohen.

- ***Gratë në politike***

Mentalitetet e kanë të vështirë të evoluojnë. Shumë shpesh, kur bëhet fjalë për të paraqitur kandidaturën, një burrë ndihet më i pavarur se një grua me kompetenca dhe cilësi të njëjta. Megjithatë shumë gra do të ishin të gatshme të investonin në jetën politike lokale, rajonale dhe kombëtare, por palët nuk do t'u jepnin atyre vendin e duhur duke vepruar shpesh në mënyre tepër hierarkike nëpërmjet luftës së klaneve dhe të tendencave.

Të Gjellbërit kanë qënë pionierë të përfaqësimit të barabartë të sekseve në zgjedhjet. Duke aplikuar thujse sistematikisht barazinë, Të Gjellbërit ia kanë dalë të feminizojnë instancat e tyre të brendshme dhe të jashtme. Ne do të vazhdojmë të ruajmë këtë traditë të mirë duke i dhënë prioritet, që listat tona elektorale të udhëhiqen nga një grua.

3.13 Një pleqëri e sigurtë

Ne duhet të kujdesemi për moshën e tretë. Ne jemi për një politik sociale dhe mbështetëse që kjo moshë të ketë një cilësi jete më të mirë. Veprimtaria mbështetëse, ku të moshuarit dhe të rinjtë ndihmojnë njëri tjetrin, duhet të zhvillohet. Të moshuarit duhet të kenë ndikim më të madh mbi format e kujdesit për ta dhe të thyhet vetmia. Ka nevojë për më shumë azile për të moshuarit si dhe për alternativa të tjera banimi. Pensioni i garantuar duhet të rritet dhe duhet të rritet kujdesi mjekësor për ata me aftësi të kufizuar. Na duhen më shumë burime mbështetëse ku shteti të luajë një rol kryesor me politikat që ndërmer.

3.14 Kafshët dhe Natyra

Pasuria dhe shumëllojshmëria ekologjike duhet ruajtur. Kjo është një çështje jo vetëm për të ardhmen tonë, por dhe një përgjegjësi morale. Në Shqipëri duhet të zgjerohet dhe ashpërsohet mbrojtja e tokës së ujitur, pyjet, plazhet dhe shumë nga biotopet tjera. Varfërimi i mjedisit natyror dhe kërcënimi i llojeve duhet të ndalohet.

Ne duhet të kujdesemi për florën dhe faunën e vendit tonë e cila paraqet një larmi të lartë biologjike.

- ***Të drejtat e kafshëve***

Kafshët keqëtrajtohen në shumë mënyra. Mund të flitet për kafshë të përvuajtura që përdoren për studime shkencore. Kafshë që vuajnë nga transportimet e gjata, apo të cila detyrohen të rrinë në kafaze të ngushta dhe që iu mungon çdo mundësi që të jetojnë jetën e tyre të natyrshme për të cilën kanë të drejtë.

Kafshët jo vetëm duhen mbrojtur me ligj, por ligji për Mbrojtjen e Kafshëve duhet të respektohet

Ne duam të ndalojmë manipulimin gjenetik dhe përdorimin e hormoneve për rritje në industrinë e mishit, si dhe importin e kafshëve dhe produkteve që janë trajtuar me këto metoda.

VLERAT KOMBËTARE

Të Gjelbërit janë për respektimin dhe zhvillimin e traditës kulturore kombëtare. Ne mbështetim fuqishëm zhvillimin e artit dhe të sportit. Zhvillimin e Shkencës e shikojme të lidhur ngushtë me modelin e kozhillimit në të ardhmen dhe në dobi të ruajtjes së burimeve natyrore. Kjo do të bëjë të mundur realizimin e modeleve ekonomike, orientimin drejt energjive të rinovueshme dhe zhvillimit të bujqësisë organike. Kultura jonë kombëtare me vlerat që ka, duhet ruajtur dhe duhet t'i trasjgohet brezave që do të vijnë si një thesar i çmuar.

EUROPA QË NE DUAM.

Të Gjelbërit janë për një Evropë të zhvillimit ekologjikisht të qëndrueshëm. Ne jemi për një ndërtim evropian që lejon pjesëmarrjen e të gjithë qytetarëve në hartimin e vendimeve që u përkasin.

Ne duam një Evropë të sigurisë së përbashkët ku demokracia dhe ekozhvillimi të jenë kushtet e një të ardhmeje evropiane të përbashkët, të hapur dhe gjeneroze.